



АГЕНЦИЈА ЗА ВРАБОТУВАЊЕ НА
РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА



РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
ОПШТИНА СТРУГА

REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMUNA E STRUGËS

ПЛОШТАД “МАЈКА ТЕРЕЗА” Б.Б., 6330 СТРУГА / SHESHI “NËNË TEREZA” P.N., 6330 STRUGË
Тел./Tel. +389 46 781 335, 781 223, 782 015, Факс/Faks 781 434
web: struga.gov.mk, e-mail: kryetari@struga.gov.mk, info@struga.gov.mk

Në bazë të Kontratës për bashkëpunim ndërmjet Agjencionit për punësim të RM (APRM), Programi për zhvillim i Kombeve të bashkuara (UNDP) dhe Komuna e Strugës, Plani operativ për programe aktive dhe masa për punësim dhe shërbime të tregut të punës për vitin 2018, i miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Programi Punë e Dobishme Komunale, financuar nga Buxheti i Agjencionit për punësim në RM, më datë 01.08.2018 shpallin :

SHPALLJE PUBLIKE deri te

personat e pa punë të evidentuar, për kyçje në Programin - Punë e Dobishme Komunale

Thirren të gjithë të evidentuarit e pa punë, të cilët janë të interesuar të kyçen në Programin – Punë e dobishme komunale, projekti „Përmirësimi i kualitetit të arsimit në institucionet parashkollore dhe shkollat fillore në komunën e Strugës” - për angazhim në punë me orar të shkurtuar në periudhë prej 9 (nëntë) muajsh për fitim të aftësive dhe gradualisht kyçje në tregun e punës, të paraqiten në Agjencionin për punësim – Qendra për punësim Strugë.

Personat e pa punë të evidentuar, të cilët janë të interesuar të kyçen në programin “Punë e dobishme komunale”, do të jenë të angazhuar në punë me orar të shkurtuar me 20 (njëzet) orë punë në javë, me çka për kohën e angazhimit në punë prej 9 (nëntë) muajsh statusi i pa punë mbetet i pa ndryshuar, kurse personave të pa punë të angazhuar që kanë të drejtë të ndihmës sociale e njëjta do ju mbetet aktive, marrja e të njëjtës edhe gjatë angazhimit.

Të drejtë për të aplikuar në programin “Punë e dobishme komunale”, kanë të gjithë të papunësuarit, kurse përparësi do tju jepet personave të cilët për herë të parë paraqiten për pjesmarrje në këtë Program.

Për kandidatët të cilët do të zgjidhen dhe inkuadrohen në Programin – “Punë e dobishme komunale”, parashihet kompenzim financiar prej 9.000,00 denarë në muaj, që përfshin tatimin personal të të ardhurave dhe sigurim në rast të lëndimit gjatë fatkeqësive gjatë punës dhe sëmundje profesionale.

Personat e pa punë të evidentuar që do të paraqiten për pjesëmarrje në Program duhet ti përkasin njërës nga grupet e mëposhtme:

- persona të pa punë të evidentuar (mbi 12 muaj evidentim),
- persona të rinj deri në 29 vjet,
- persona shfrytëzues së ndihmës sociale ose të kompenzimit në të holla të pa punë,
- persona që kanë status, fëmijë pa prindër ose kujdestari prindërore,
- femra pjestare të komuniteteve më të vogla etnike
- prindër me fëmijë me pengesa në zhvillim
- prindër me 3 ose më shumë fëmijë.

Pozicionet e punës që përfshihen në këtë konkurs kanë të bëjnë me angazhimin e :

Asistentë edukativ për fëmijë me pengesa të lehta në zhvillim në proces të rregull arsimor

Asistentë edukativ	Profesorë të diplomuar për mësimdhënie, pedagogë, psikologë, defektologë.	Asistim në mësimdhënie të përditshme për fëmijë me pengesa të lehta në zhvillim psiho-fizik; 5 (pesë) ditë pune në javë me kohëzgjatje të procesit të mësimdhënies në shkollat fillore; Punë me detyrat e fëmijës, në klasë dhe detyrat e shtëpisë dhe ndihmë për plotësim dhe shpjegim të përmbajtjeve të ndryshme për fëmijën.
---------------------------	---------------------------------------------------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Personat e pa punë, të interesuar për pjesëmarrje në Program mund të paraqiten te Agjensioni për punësim – Qendra për punësim Strugë, në periudhën prej **01.08.2018 deri më 14.08.2018, prej orës 08:00 deri 14:00.**

Kushte më konkrete, të drejta dhe obligime do të rregullohen në Kontratën lidhur mes Komunës së Strugës dhe kandidatit të përzgjedhur.

Informacione më të detajuara për Programin mund të merren në:
Komunën e Strugës - Besa Ziba, Koordinatore komunale për programin,
Agjensioni për punësim - Qendra për punësim -Dreni Dauti dhe
Qendra për punë sociale - Vegim Nura.